



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.996/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rustem Thaqi - kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Mehmet Ndrecaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: B.G. nga Suhareka, të cilin e përfaqëson Xh.B., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurës: Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rr. "...", pn., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar L.B. sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.nr.59/2016 i datës 08.11.2017, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 16.12.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rr. "...", pn., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.nr.59/2016 i datës 08.11.2017, në pikën I, II të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë dhe për ushqimin e përforcuar si dhe në pikën III, të dispozitivit për shpenzimet e procedurës, VERTETOHET.

II. PRANOHET pjesërisht ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rr. "...", pn., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.nr.59/2016 i datës 08.11.2017, në pikën II, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë, sa i përket dëmit jomaterial: për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor dhe gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura: Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rr. "...", pn., që paditësit: B.G. nga ..., në emër të kompensimit të dëmit jo material, të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 11.01.2016, ti paguaj shumat e specifikuara dhe atë: për dhembjet e përjetuara fizike t'ia paguaj shumën prej 3.500 €, për frikën e përjetuar shumën prej 2.200 €, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 6.000 € dhe për shëmtimin trupor shumën prej 1.000 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për dhembjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësorë dhe shëmtimin trupor, përtej shumës së gjykuara, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. PRANOHET pjesërisht ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rr. "...", NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.nr.59/2016 i datës 08.11.2017, në pikën II, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kamatën dhe gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura që paditësit ti paguajë kamatën 8%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 08.11.2017, e deri në pagesën definitive.

IV. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën III, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.59/2016, i datës 08.11.2017, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Miratohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit B.G. nga Suhareka e bazuar. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet e paditura K.S. "...", me seli në Prishtinë, të bëjë kompensimin e dëmit moral dhe material paditësit B.G., si në vijim: për zvogëlimin e aktivitetit jetësor prej 15 % shumën prej 10.000 €, në emër të përjetimit të të gjitha formave të dhimbjeve fizike shumën prej 4.500 €, në emër të të gjitha formave të frikës shumën prej 3.500 €, në emër të shëmtimit të shkallës së ulët shumën prej 2.500 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë në kohëzgjatje prej 10 javë shumën prej 700 €, në emër të ushqimit të përforcuar për 3 muaj shumën prej 270 €. Respektivisht për paditësin B.G., për të gjitha kategoritë siguroese shumën e përgjithshme 18.970 €, me kamatë ligjore 8% nga dita e parashtrimit të padisë, të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve dhe procedurës të i paguaj paditësit shumën prej: për padi shumën prej 208 €, për përpilimin e precizimit të kërkesëpadisë shumën prej 208 €, taksa e padisë 100 €, shpenzimet e eksperteve të mjekësisë 300 €, për 4 seancat e mbajtura nga 270.40 € për seancë $4 \times 270.10 = 1.081.60$ €, shuma e përgjithshme e shpenzimeve të procedurës është 1.897,60. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e kërkuara Refuzohet si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën si të tillë ta aprovoj, aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i paditësit ka kërkuar që Gjykata e Apelit ta refuzoj ankesën e të paditurës si të pathemeltë dhe ta vërtetoj aktgjykimin e goditur të gjykatës së shkallës së parë ashtu siç parashihet me nenin 195 shkronja d) e LPK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi: B.G. nga Suhareka, përmes të autorizuarit të tij, me datë 01.03.2016, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, të precizuar si në parashtrësën e datës 03.11.2017, kundër të paditurës: Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të: I. Të obligohet KS "...", me seli në Prishtinë që ta kompensoj për të gjitha format e dëmit paditësin B.G. në shumë prej 29.370 €. Të obligohet KS "...", që shpenzimet e procedurës ti paguaj si në vijim: përpilimin e padisë shuma prej 208 €, taksa e padisë 26 €, për shpenzimet e eksperteve të mjekësisë në shumë prej 300 €, për seancat e mbajtura $270.40 \times 4 = 1081.60$ €, për precizimin e kërkesëpadisë 208 € si dhe taksa për aktgjykim në shumë prej 150 €. Shuma e përgjithshme për shpenzimet e procedurës është 1.973,60 €. (Kontesti në vlerë mbi 10.000 €).

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresat tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.59/2016, i datës 08.11.2017, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese baza e kërkesëpadisë, por lartësia e kërkesëpadisë, andaj gjykata duke vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë, e ka miratuar kërkesëpadinë pjesërisht të paditësit, duke pasur për bazë moshën e paditësit, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe lëndimet e paditësit dhe atë duke pasur parasysh praktikat gjyqësore në Kosovë.

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit jomaterial dhe material, gjykata e shkallës së parë, në cilësinë të provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor, Mr.sci.dr. G.J. ortoped - traumatolog, Dr. F.M. ortoped - traumatolog, dhe Dr. K.B. ortoped - traumatolog, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në superekspertizën mjekësore të datës 17.10.2017, kanë konstatuar se: paditësi B.G. ka pësuar këto lëndime trupore në aksident trafiku: thyerje të pjesës proksimale të kërcirit të djathtë, ndrydhje të gjoksit dhe kokës dhe plagë shkyese gërvishëse me madhësi 2cm në pjesën e djathtë të ballit, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuar paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 1 orë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të cilat kanë zgjatur për 3 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur 6 javë, dhimbje fizike të intensitetit të ulët të cilat ekzistojnë edhe sot e kësaj dite. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor 15 % vlerësimi është bazuar në kapitullin II, gjymtyrët e poshtme nen 2.3 gjuri dhe kërciri, pika 2.3.6 nen b) ngjitja jo e rregullt e thyerjes së kërcirit me angullacion mbi 15 shkallë e manifestuar në përqindje 15 %. Kujdesi i huaj dhe ndihma ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 javë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 3 muaj. Rehabilitimi fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm dy herë nga 15 ditë në vitin e parë pas lëndimit si dhe një herë 15 ditë në vitin e dytë. Sa i përket shëmtimit trupor gjykata e shkallës së parë në cilësi të provës ka marr mendimin e ekspertit mjekësor Dr. Rr.Sh. ortoped, i cili në shqyrtimin kryesor të datës 04.07.2017 ka deklaruar se: paditësi ka shëmtim trupor në shkallë të lehtë për shkak të vrragës që ka në pjesën e djathtë të ballit me madhësi 2cm e cila tani vështirë është e dukshme. Ndërsa sa i përket frikës, gjykata e shkallës së parë në cilësi të provës ka marr mendimin e ekspertit mjekësor Dr. N.F., psikiatër i cili në shqyrtimin kryesor

të datës 05.09.2017, në mendimin e tij profesional ka deklaruar se: paditësi si pasojë e këtij aksidenti ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 24 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 1 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët 1 vit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 136 paragraf 1, 137 paragraf 1, 169 paragraf 1, pika 3, 174, 183 paragraf 1 pika 2, nenit 9 paragraf 1 dhe nenit 10 të Ligjit për Sigurime të Detyrueshme nga Autopërgjegjësia, lidhur me nenin 323 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjyimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjyimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesës të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë 11.01.2016, rreth orës 20:05 minuta, në rrugën “Brigada 123” pasi kalon stacionin policor rreth 50m në Suharekë, përkatësisht në vendkalimin për këmbësor. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te këtu e paditura, shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit i tipit “Daewo Kalt”, me targa ... ngjyrë e kuqe, të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte B.Z. nga fshati ..., Komuna e Suharekës, i siguruar i këtu të paditurës, këtu paditësi nuk ka përgjegjësi në shkaktimin e këtij aksidenti, si pasojë e këtij aksidenti paditësi pëson lëndime të rënda trupore. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga palët - këtu e paditura, gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë, nuk e ka kundërshtuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit - përgjegjësinë e siguruarit të saj, siç është deklaruar përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 19.06.2017, nuk ka kontestuar faktin se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, nuk ka kontestuar se paditësi ka përjetuar dhembje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor, si pasojë e këtij aksidenti siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para

gjykatës gjatë procesit gjyqësor”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë dhe më qëllim që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.11.2017 i ka ofruar ofertë në lartësi prej 5.000 €, si dhe shpenzimet e procedurës, të cilën ofertë paditësi nuk e ka pranuar. Po ashtu me nenin 180 paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: “ Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe propozohen prova të reja përveç se kur ankuesi i jep prova se pa fajin e vetë nuk mund ti paraqes përkatësisht ti propozoj gjerë në shqyrtimin kryesor në gjykatën e shkallës së parë ”.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe kujdesin e personit tjetër dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit ”. Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi ka pasur nevojë për ndihmë të huaj prej 10 javë dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 3 muaj, ku të njëjtë i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve ju njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdes nga personi i tretë. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket dëmit jomaterial për dhembjet fizike, friken e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe për shëmtimin trupor, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për kategoritë e dëmit jomaterial dhe atë: për dhembjet fizike, frikën e përjetuar, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe për shëmtimin trupor, pasi që vlerësoj se shumata e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit. Në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarin. Mbi këtë bazë gjykata duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, shkallen e zvogëlimin të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 15 %, shëmtimin trupor - shkalla e ulët e shëmtimit si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plot me nenin 183 të LMD-së.

Aktgjykimi është ndryshuar sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 08.11.2017, e deri në pagesën definitive, sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pika III, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadsisë, nuk është shqyrtuar, sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadsisë.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.996/18, me datë 16.12.2019

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi, d.v